



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 8.3.2023

Nr: 136

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA REFORMAVE DEMOKRATIKE SHQIPTARE”,  
PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE  
TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë, 8.3.2023 në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1334 Prot., datë 6.3.2023, me:

**Kërkues:** Partia politike “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare”, me kryetar z. Krenar Rryci

**Objekti:** Regjistrimi i partisë politike “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

**Baza ligjore:** Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

“Partia e Reformave Demokratike Shqiptare”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Krenar Rryci, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023, administruar.

Data: 8.3. 2023 Nr: 136  
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Reformave Demokratike Shqiptare”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 6.3.2023, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare”, me iniciale “PRDSH”, me kryetar z. Krenar Rryci rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike, (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare” me shkronja nistore “PPRDSH”, me adresë Rruga “Muhamet Gjollësia”, ish shtypshkronja “8 Nëntori”, kati i 3-të nr.30, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Krenar Rryci, me adresë Rruga “Gjergj Legjisi”, P-N, kati i 1-rë, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është znj. Santiliana Muho, me adresë Kompleksi “Dinamo” P-123/3, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Pjetër Deda, me adresë Rruga “Berlusconi” nr. 5, Kamëz, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues kërkesës, i paraqitur nga “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, nenin 64, pika 2 dhe nenin 92 /2 pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të udhëzimit nr.1, datë 18.1.2023, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”

## VENDOSA:

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare”, me kryetar z. Krenar Rryci, me shkronjat nistore “PRDSH”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**